



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 maj 2023  
Nr. ref.:RK 2168/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI16/21**

Parashtrues

**Pal Gruda dhe Zef Gruda**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit  
të Gjykatës Supreme të Kosovës, PA-II. nr. 2/2020, të 8 tetorit 2020**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Pal Gruda dhe Zef Gruda, nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Korab Bokshi dhe Teki Bokshi, avokatë nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [PA-II. nr. 2/2020] e 8 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [APS. nr. 6/2019] të 4 majit 2020, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 76/18] të 24 majit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesit e kërkesës vendimin e kontestuar e kanë pranuar më 13 janar 2021.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 11 janar 2021, parashtruesit e kërkesës përmes postës dorëzuan kërkesën, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 19 janar 2021.
7. Më 25 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu, (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 29 janar 2021, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të plotësojnë formularin zyrtar dhe t'ia dorëzojnë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.
9. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 18 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës Pal Gruda dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të plotësuar të kërkesës në emër të tij dhe në emër të parashtruesit Zef Gruda.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa

- Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e mori pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
  13. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama Hajrizi nxori Vendimin [Nr. KSH. KI16/21] dhe emëroi në Kolegj shqyrtues gjyqtarin Bajram Ljatifi në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
  14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP-71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja, Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
  15. Më 23 dhjetor 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren dosjen e plotë të rastit.
  16. Më 12 janar 2022, Gjykata pranoi dosjen e plotë të rastit.
  17. Më 25 maj 2022, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës Pal Gruda, që të dorëzoj një autorizim që e përfaqëson z. Zef Gruda para Gjykatës ose të dorëzoj kërkesën e nënshkruar nga ai.
  18. Më 13 qershor 2022, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë një shkresë përmes së cilës kërkuan që kërkesa KI16/21 të bashkohet me kërkesën KI09/22 dhe gjithashtu dorëzuan edhe autorizimin për përfaqësim para Gjykatës. Gjykata vendosi që kërkesën aktuale KI16/21 ta trajtoj ndaras nga kërkesa KI09/22 e vendosur përmes Aktvendimit për papranueshmëri të 16 nëntorit 2022.
  19. Më 17 janar 2023, gjyqtari Enver Peci, në bazë të nenit 18 (Përjashtimi i gjyqtarit) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kërkoi përjashtimin e tij nga vendimmarrja në rastin KI16/21.
  20. Më 17 janar 2023, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. Ref. KK13/23] aprovoj kërkesën e Gjyqtarit Enver Peci për përjashtim.
  21. Më 4 prill 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

22. Parashtruesit e kërkesës i kontestojnë vendimet e gjykatave të rregullta të nxjerra në procedurat gjyqësore të zhvilluara kundër të akuzuarve T. K., K. K., GJ. K., M. K., B. B., Gj. K., dhe G. K., ku parashtruesit e kërkesës paraqiten si palë e dëmtuar në lëndën [PKR. nr. 76/18] e cila është zhvilluar në Gjykatën Themelore.
23. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se të akuzuarit e lartpërmendur duke vepruar si grup i organizuar e duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personave të ndryshëm, përfshirë edhe parashtruesit e kërkesës iu kishin huazuar atyre shuma të parave dhe më pas i kishin detyruar ata që të paguajnë kamatat joproporcionale.

24. Më 18 maj 2016, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ngriti Aktakuzë [PPS. nr. 49/2015] kundër të akuzuarve T. K., K. K., GJ. K., M. K., B. B., Gj. K., dhe G. K., nën dyshimin se në bashkëkryerje kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme nga nenet 267, 274, 208, 300, 343 dhe 374 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal nr. 04/L-082 të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kodi Penal), si dhe në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr. 03/l-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
25. Më 24 maj 2019, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [PKR. nr. 76/18] nëpërmjet të cilit i shpalli fajtorë të akuzuarit - K. K., T. K, Gj. K., M. K., B. B., B. O., Gj. K, dhe G. K., për kryerjen e veprave penale të ndëshkueshme nga nenet 267, 274, 300, 343, 374 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal, me arsyetimin se *“të akuzuarit me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt të dobisë financiare, vazhdimisht kanë kryer vepra penale, në atë mënyrë që i pandehuri T.K i ka mbikëqyrur dhe i ka drejtuar veprimet e këtij grupi kriminal, i cili grup ka vepruar duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare ose papërvojën e të dëmtuarve të ndryshëm duke kontraktuar me të njëjtit huazimin e shumave të ndryshme financiare dhe pastaj duke përdorur kërcënimet e rënda, me ç’ rast të dëmtuarit janë detyruar që të paguajnë kamata dukshëm joproporcionale në formë të pasurisë ose shumave të shumëfishta të të hollave në këmbim me shumën e huazuar ose ta kryejnë ndonjë veprim tjetër në dëm të pasurisë së tyre [...]”*.
26. Gjykata Themelore nëpërmjet vendimit të saj shqiptoi dënimet për personat e lartpërmendur si në vijim:
- (i) **K. K.** për veprën penale detyrimi nga neni 267, paragrafi 2 të Kodit Penal dhe fajdeja nga neni 343, paragrafi 3 të Kodit Penal, dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në masën paraburgimit nga 28 maji 2015 gjerë më 11 tetor 2015, si dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 të Kodit Penal, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro.
  - (ii) **T. K.** për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 32 e nenin 31 të Kodit Penal, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 3 (tre) muaj dhe ia ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga 28 maji 2015 gjerë më 29 gusht 2017, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 të Kodit Penal, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro.
  - (iii) **Gj. K.** për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2, si dhe në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj dhe i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga 25 maji 2015 e gjerë më 11 tetor 2017, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 të Kodit Penal, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro.
  - (iv) **M. K.** për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 të Kodit Penal, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro.

- (v) **B. B.** për veprën penale detyrimi nga neni 267, paragrafi 2 të Kodit Penal, si dhe fajdeja nga neni 343, paragrafi 3 të Kodit Penal, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgimin nga 28 maji 2015 e gjerë më 3 tetor 2015, si dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374, paragrafi 1 i Kodit Penal, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) euro, të cilin e ka obliguar që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguaj gjobën, në të kundërtën dënimi do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ku do t'i llogaritet për çdo 20 euro të gjobës me një ditë burgimi.
  - (vi) **B. O.** për veprën penale detyrimi nga neni 267, paragrafi 2 të Kodit Penal për të cilin i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj, të cilit ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, përkatësisht arrest shtëpiak nga 28 maji 2015 gjerë më 30 qershor 2017.
  - (vii) **Gj. K.** për veprën penale fajdeja nga neni 343, paragrafi 1 të Kodit Penal, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve dhe dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) €, në këtë dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga 28 maji 2015 gjer më 26 janar 2016.
  - (viii) **G. K.** për veprën penale fajdeja nga neni 343, paragrafi 1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënimin me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) €, në dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga 11 tetori 2015 e gjer më 9 shkurt 2016. Dënimin me burgim me pëlqimin e të akuzuarit e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi prej 3.000 (tremijë) euro, që të akuzuarin e ka detyruar që këtë shumë ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, e në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë të njëjtit do t'i zëvendësohet nga dënimi me gjobë në dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 euro të gjobës me një ditë burgim.
27. Gjykata Themelore përmes të njëjtit Aktgjykim [PKR. nr. 76/2018] i kishte liruar nga akuza të akuzuarit si në vijim:
- (i) **T. K.** për veprën penale krimi i organizuar nga neni 274, paragrafi 3 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 267, paragrafi 2 e lidhur me nenin 23 të Kodit Penal, si dhe veprën penale fajdeja nga neni 343, paragrafi 3 të Kodit Penal.
  - (ii) **Gj. K. dhe M. K.** i ka liruar nga akuza për veprën penale krimi i organizuar nga neni 274, paragrafi 1 të Kodit Penal, lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 267, paragrafi 2 të Kodit Penal dhe veprën penale fajdeja nga neni 343, paragrafi 3 të Kodit Penal lidhur me nenin 23 të Kodit Penal.
  - (iii) **K. K., B. B. dhe Gj. K.** i ka liruar nga akuza për veprën penale krimi i organizuar nga neni 274, paragrafi 1 të Kodit Penal, po ashtu të akuzuarit T. K., K. K., B. B., M. K. dhe Gj. K. i ka liruar nga akuza për veprën penale shpëlarje e parave nga neni 308 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal e lidhur me nenin 32, paragrafët 1 dhe 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit [nr. 03/l-196 ] për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

28. Gjykata Themelore vendimin e saj e kishte bazuar duke u mbështetur në konstatimet se:

*“Gjatë muajit mars të vitit 2012 me qëllim të lartcekur, i pandehuri B. B. ia ka huazuar të dëmtuarit Pal Grudaj shumën prej 20.000 € (njëzet mijë) për t’ia kthyer kinse në afat prej 2 muajve, por disa ditë para skadimit të këtij afati i pandehuri të dëmtuarit Pal i është kërcënuar rëndë duke thënë se do t’i dërgoj njerëz të vetë tek babai i të dëmtuarit - Zef Gruda dhe ata nga i njëjti do t’i marrin paratë me forcë nëse i dëmtuari Pal nga ajo ditë nuk e paguan kamatën mujore në shumë prej 3.000 € (tre mijë) ose 500 € (pesëqind) në ditë për çdo ditë të vonesës në pagimin e kamatës, ashtu që gjatë 6-7 muajve të ardhshëm i dëmtuari, i frikësuar, rregullisht ia ka paguar kamatën mujore në shumë prej 3.000 € [...]”. Në fillim të muajit qershor 2012, me qëllim të cekur më lart, anëtari tjetër i këtij grupi të organizuar kriminal- i pandehuri K. K. e ka thirrur të dëmtuarin Pal Grudaj dhe ia ka ofruar shumën prej 15.000 € që t’ia paguaj borxhin të pandehurit B. B. të cilën shumë i njëjti e ka pranuar dhe menjëherë ia ka ofruar të pandehurit B. B., por ky i pandehur, sipas marrëveshjes brenda grupit të organizuar kriminal, e ka refuzuar duke kërkuar kamatën e cila e ka rritur shumën në 23.000 € (njëzet e tre mijë), ashtu që deri në fund të muajit nëntor të vitit 2012, i dëmtuari Pal Grudaj duke i paguar kamatat mujore prej nga 3000 € (tre mijë), pastaj kamatë dënuese ditore në shumë prej 500 € (pesëqind) ose javore në shumë prej 5.000 € (pesë mijë) ia ka paguar të pandehurit B. me shumë se 40.000 € (dyzet mijë), por ky i pandehur megjithatë, nga i njëjti ka kërkuar edhe 60.000 € (gjashtëdhjetë mijë) tjera, në afatin prej një jave, por meqenëse në të njëjtën kohë në të dëmtuarin ka bërë presion edhe i pandehuri K. K., i pandehuri B. nuk ka insistuar më tutje me kërkesën e lartcekur.[...]”*

29. Më këtë rast, Gjykata Themelore dënoi të akuzuarit, përveç tjerash, me burgim, respektivisht K. K., dënoi me burgim prej 3 (tri) vitesh dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1500 euro; T. K., dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1500 euro; Gj. K., dënim me burgim prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj dhe dënim me gjobë prej 1500 euro; M. K., dënim me gjobë në vlerë prej 1500 euro; Gj. K., dënim me burgim prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1500 euro; B. B., dënim me burgim prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1500 euro; B. O., dënim me burgim 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj; GJ.K., dënim me burgim prej 8 (tetë) muaj dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1000 euro; G. K., dënim me burgim prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1000 euro.
30. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj, palët e dëmtuara duke përfshirë parashtruesit e kërkesës në cilësinë e të dëmtuarve i ka udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në procedurë civile kontestimore, duke theksuar si në vijim:

*“Të dëmtuarit: Pal Gruda, Zef Gruda, F.G., B.Q., M.N., B.N., F.G., Sh.B., M.A., N.Q., K.G., dhe A.Z., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil”.*

31. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore [PKR. nr. 76/18], Prokuroria Speciale parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe rasti të kthehet në rigjykim në Departamentin Special në Prishtinë, si dhe të urdhërohet konfiskimi i të gjitha asetëve që janë liruar përmes aktgjykimit të ankimuar.

32. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore [PKR. nr. 76/18], të akuzuarit, T.K., K.K., GJ.K., M.K., B.B., Gj. K., dhe G. K., ushtruan ankesë në Gjykatën e Apelit.
33. Më 3 tetor 2019, Prokuroria e Apelit në Prishtinë, paraqiti parashtrësën me shkrim [PPA/L nr. 448/2019] dhe i propozoi Gjykatës së Apelit t' i refuzojë ankesat e të akuzuarve, ndërsa ankesën e Prokurorisë Speciale ta aprovoj si të bazuar.
34. Më 4 maj 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS. nr. 06/2019] e aprovoi ankesën e Prokurorisë Speciale dhe për pasojë ndryshoi pjesërisht aktgjykimin e ankimuar.
35. Më saktësisht, Gjykata e Apelit ndryshoi pjesërisht aktgjykimin e ankimuar në pjesën liruese, duke i shpallur fajtorë të akuzuarit T. K., K. K., Gj. K., M. K., B. B., Gj. K., G. K., për veprat penale detyrimi nga neni 328, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal dhe për veprën penale fajde nga neni 343, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal duke gjykuar të akuzuarit - T. K., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite dhe dënim me gjobë në shumën prej 20.000 (njëzetmijë) euro; K. K., dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) euro; Gj. K. dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjet e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) euro. M. K., dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në shumën prej 5.000 (pesëmijë) euro; B. B. dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) euro; Xh. K., dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në shumën prej 5000 (pesëmijë) euro; dhe Gj. K., dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në shumën prej 5000 (pesëmijë) euro.
36. Gjithashtu, Gjykata e Apelit përmes të njëjtit aktgjykim ndryshoi pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit B. O., për veprën penale detyrimi nga neni 267, paragrafi 2 të Kodit Penal, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. **T. K.** për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tetë) muaj. **Gj. K.** për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tetë) muaj. Ndërsa të akuzuarit **T. K., Gj. K., B. B., M. K. dhe K. K.**, për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 2 të Kodit Penal, për të cilën janë shpallur fajtorë e ndryshon aktgjykimin, ashtu që secilit të akuzuar iu shqipton dënimin me gjobë në shumën prej nga 5.000 (pesëmijë) euro. Në mbështetje të nenit 80 të Kodit Penal, të akuzuarve iu shqiptua dënimi unik si në vijim: **T. K.** me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 25.000 (njëzetepesëmijë) euro, në këtë dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, **K. K.** me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 25.000 (njëzetepesëmijë) euro, në këtë dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Gj. K. me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj, dhe dënim me gjobë në shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro, në këtë dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. **M. K.** me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, dhe dënim me gjobë në shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) €, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. **B. B.** me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 25.000 (njëzetepesëmijë) euro, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Gjykata e Apelit anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rigjykim

dhe rivendosje vetëm sa i përket veprës penale të shpëlarjes së parave si në pikën II të diapozitivit dhe pjesës së konfiskimit të pasurisë.

37. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj, palët e dëmtuara, respektivisht parashtruesit e kërkesës i ka udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në procedurë civile kontestimore, duke theksuar si në vijim:

*“Të dëmtuarit udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në procedurën civile kontestimore”,*

38. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, të akuzuarit paraqitën ankesë në Gjykatën Supreme me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal.
39. Prokurori i Shtetit përmes shkresës [PPA-III-NR.5/2020] propozoi që të refuzohen ankesat e të akuzuarve si të pabazuara.
40. Më 8 tetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PA-II. nr. 2/2020] anulon Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [APS. nr. 06/2019] të 4 majit 2020, me arsyetimin se aktgjykimi i kontestuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, pika 1.12 lidhur me nenin 370 të Kodit të Procedurës Penale, dhe ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën e Apelit si dhe vendosi që paraburgimi ndaj të akuzuarve të vazhdohet.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

41. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 KEDNJ-së.
42. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se shkelja e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës ka ndodhur si pasojë e mosdorëzimit të vendimeve të gjykatave të rregullta në mënyrë që parashtruesit e kërkesës të kishin mundësi që në cilësinë e palës së dëmtuar të merrnin pjesë në procedurat gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e rregullta dhe të paraqitnin ankesat/prendimet e tyre.
43. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Gjykata Themelore në Prizren, mua si palë e dëmtuar nuk më ka dërguar Aktgjykimin e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë po ashtu nuk më ka dërguar kopjet e ankesave të të akuzuarve, edhe pse e ka pasur detyrim ligjor, neni 388, par.2. e KPPRK-së. Më është pamundësuar që të paraqesë përgjigje në ankesat e të akuzuarve ngase Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore. Në situata të tilla, zakonisht gjykatat e instancës i kthen shkresat e lëndës Gjykatës së shkallës më të ulët, në mënyrë administrative, duke urdhëruar ekspedimin e shkresave të duhura që të krijohen kushtet procedurale që Gjykata kompetente të vendos ankesat në procedurë të rregullt”.*
44. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë *“Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, APS.nr. 6/2019 dt. 04.05.2020 mua si palë e dëmtuar nuk më është dërguar. Me këtë më është pamundësuar që të paraqesë ankesë kundër Aktgjykimit të*



- përmendur të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Mua nuk më janë dërguar ankesat e të akuzuarve kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, edhe pse Gjykata e Apelit apo ajo Themelore ka pasur detyrim ligjor, neni 388, par. 2. e KPPRK-së të më dërgoj ankesat. Më është pamundësuar që të paraqesë përgjigje në ankesat e të akuzuarve”.*
45. Në lidhje me procedurën e zhvilluar në Gjykatën Supreme, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Unë në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, PA-II.nr. 2/2020 jam përjashtuar në tërësi. Bile as që kam pasur informacion se lënda ka shkuar në procedim të mëtejshëm në Gjykatën Supreme. Përveç pamundësimin të paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe të asaj të Apelit, meqë nuk më janë dërguar as aktgjykimet e as ankesat e palëve kundërshtare, unë nuk jam ftuar në seancën e Kolegjit ankimor pranë Gjykatës Supreme të Kosovës”.*
46. Në lidhje me pretendimin e tyre për mos njoftim lidhur me vendimet e gjykatave të rregullta, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Gjykatat, sipas dispozitave të KPPRK-së kanë detyrim që ftesat dhe vendimet gjyqësore t’ia dërgoj gjithësesi të dëmtuarit e edhe të autorizuarit të tij. Subjekt qendror është i dëmtuari (si edhe Prokurori dhe i akuzuari). Këshilltari ligjor, avokati, qoftë si mbrojtës i të akuzuarit apo përfaqësues i autorizuarit i të dëmtuarit është këshilltar ligjor i autorizuar, por prezenca - angazhamenti i tij nuk i liron gjykatat që të komunikojmë me ftesa, parashtrësia dhe vendime gjyqësore, për të mundur edhe vet i dëmtuari që të paraqesë parashtrësia, ankesa, që të asistoj në seanca dhe shqyrtime gjyqësore. Andaj, informimi në këtë aspekt i imi si i dëmtuar gjykimin lëndor e bere arbitrar dhe shkeljet e tilla nuk janë vetëm ligjore por edhe shkelje e garancioneve kushtetuese [...]”.*
47. Përgjatë kërkesës së tyre, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“E kam parasyrsh se çështja nuk ka përfunduar në meritum, por në procedurën e tashmë janë bërë shkelje të cilat janë të pariparueshme, të cilat as në riprocedurë nuk ka mundësi që të eliminohen pasojat e këtyre shkeljeve. Po të më mundësohej paraqitja e ankesës kundër Aktgjykimit të apelit, për çështje të kërkesës pasurore juridike dhe për shpenzimet kolosale të procedurës, po të ftoheshin në seancë të Kolegjit në Gjykatën Supreme të Kosovës, sigurisht që do të prezantoja pretendimet e mia. Pse Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit nuk më ka gjykuar dëmin e shkaktuar, i cili është vërtetuar në procedurën penale. Unë tani do të duhet që të kërkoj kompensimin në procedurë juridiko civile, në procedurë kontestimore, të cilën të drejtë paraprakisht do të duhet të paguaj shpenzime shumë të larta procedurale”.*
48. Parashtruesit e kërkesës tutje nënvizojnë: *“Duhet të keni parasyrsh se mua si palë e dëmtuar më është shkaktuar dëm marramendës, disa qindra mijë euro, siç shihet edhe nga gjendja në shkresat lëndës, përveç dëmit moral, jo material, tërë familjes”.*
49. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Shumat monetare nga të cilat jam privuar me veprimet kriminale të akuzuarve janë vërtetuar saktësisht dhe ka pas mundësi që pa e ngarkuar procesin penal, të gjykohej kërkesa pasurore juridike. Me veprim të tillë procedura e deritanishme më është shkelur edhe e drejta e garantuar me nenin 1. të Protokollit shtesë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”.*
50. Në përfundim, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Kërkoj që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të deklaroj se më janë shkelur të drejtat e mia procedurale dhe materiale nga Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, ashtu që në raport me mua janë bërë lëshime dhe me është shkelur e drejta për qasje në drejtësi, në kuptim të nenit 6 të Konventës*

*Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore, e cila në Republikën e Kosovës zbatohet drejtpërdrejtë dhe me prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, e në kuptim të nenit 221. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Më është shkelur E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, e garantuar me nenin 31, par. 1 - 3 të Kushtetutës së RKS [...]*”.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*

#### **Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]**

*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

#### **Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]**

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

## KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

### Neni 13

#### E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

#### Protokolli nr. 1 neni 1 [Mbrojtja e Pronës]

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

#### KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

### Neni 463

#### Vendimi mbi propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike

1. Për kërkesat pasurore juridike vendos gjykata.

2. Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.

#### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

51. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

52. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

53. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatit]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

54. Gjykata në vijim, konstaton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PA-II nr. 2/2020], të 8 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

55. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (b) dhe (2) si dhe (3) (b) i Rregullores së punës, përcaktojnë që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:”*

[...]

*(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar*

[...]

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

56. Gjykata, para së gjithash, rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurën penale e cila është iniciuar dhe zhvilluar kundër personave T. K., K. K., GJ. K., M. K., B. B., Gj. K., G. K., për kryerjen e veprave penale të ndëshkueshme nga neni 267, 274, 300, 208, 343 dhe 374 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal, në të cilin rast - parashtruesit e kërkesës ishin palë e dëmtuar.
57. Në procedurën e zhvilluar penale ndaj T.K., K.K., GJ.K., M.K., B.B., Gj. K., G.K. Këta të fundit përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishin shpallur fajtorë dhe dënuar me gjobë në një shumë të caktuar të hollash, përderisa parashtruesi i kërkesës në cilësinë e palës së dëmtuar ishte udhëzuar në kontest civil. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte ndryshuar pjesërisht nga ana e Gjykatës së Apelit ashtu që i shpalli fajtorë të akuzuarit duke e ashpërsuar dënimin me burgim dhe me gjobë ndaj tyre dhe udhëzoi palët e dëmtuara në kontest civil. Pas ankimimit, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PA-II. nr. 2/2020] anulon vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën e Apelit.
58. Për pasojë, parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme që ndërlidhet me një *“akuzë penale”* kundër disa personave të tretë, gjegjësisht T. K., K. K., GJ. K., M. K., B. B., Gj. K., G. K., me pretendimin se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese, të garantuara me nenin 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
59. Gjykata, në vijim, do t'i trajtojë veç e veç secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

### ***Pretendimi për shkelje të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës***

60. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përgjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e rregullta ishin përjashtuar nga mundësia që në cilësinë e palës së dëmtuar të merrnin pjesë në procedurat gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e rregullta dhe të paraqitnin ankesat/prendimet e tyre, e gjitha kjo sipas tyre përben shkelje të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës
61. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e arsyetojnë pretendimin për shkelje të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës si pasojë e mosdorëzimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, në mënyrë që parashtruesit e kërkesës të kishin mundësi që në cilësinë e palës së dëmtuar të merrnin pjesë në procedurat gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e rregullta dhe të paraqitnin ankesat/prendimet e tyre.
62. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk ia kanë dorëzuar parashtruesve të kërkesës vendimet e nxjerra siç i detyron paragrafi 2 i nenit 388 të Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që parashtruesit e kërkesës të kishin mundësinë që të paraqesin pretendimet e tyre

përgjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore, respektivisht të përgjigjen në ankesat e të akuzuarve.

63. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë përjashtuar nga mundësia që të paraqesin pretendime lidhur me kërkesën pasurore juridike në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Supreme, e cila kishte rezultuar me nxjerrjen e Aktvendimit [PA-II. nr. 2/2020] për anulim të Aktgjykimit [APS. nr. 06/2019] të 4 majit 2020, të Gjykatës së Apelit dhe rikthim të rastit në rigjykim.
64. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thekson: “[...] *Po të më mundësohej paraqitja e ankesës kundër Aktgjykimit të apelit, për çështje të kërkesës pasurore juridike dhe për shpenzimet kolosale të procedurës, po të ftohesha në seancë të Kolegjit në Gjykatën Supreme të Kosovës, sigurisht që do të prezantoja pretendimet e mia. Pse Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit nuk më ka gjykuar dëmin e shkaktuar, i cili është vërtetuar në procedurën penale. Unë tani do të duhet që të kërkoj kompensimin në procedurë juridiko civile, në procedurë kontestimore, të cilën të drejtë paraprakisht do të duhet të paguaj shpenzime shumë të larta procedurale*”.
65. Nën dritën e pretendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngritë pretendime që hyn në objektin ose fushëveprimin e nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Perez kundër Francës, kërkesa nr. 47287/99](#), Aktgjykim i 12 shkurtit 2004).
66. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës ishin pjesë e procesit gjyqësorë, në cilësinë e dëshmitarëve dhe palës së dëmtuar gjatë shqyrtimit kryesor të rastit kundër të akuzuarve të zhvilluar në Gjykatën Themelore. (Shih rastin e GJEDNJ-së, [Perez kundër Francës, kërkesa nr. 47287/99](#), cituar me lartë).
67. Në kontekst të pretendimit për mos pranim të vendimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se mbrojtësi i autorizuar i parashtruesve të kërkesës kishte ngritur pretendime në emër të parashtruesve të kërkesës, i cili kishte theksuar si në vijim:

*“Përfaqësuesi i të dëmtuarve, avo. Tom Gashi, në fjalën e tij përfundimtare në tërësi përkrahu prokuroren e PS, duke shtuar se të gjithë të akuzuarit janë mbrojtur në heshtje, po ashtu mbeti në tërësi pranë fjalës përfundimtare të përfaqësuesit të mëparshëm të dëmtuarve Zef dhe Pal Gruda dhe besoj se gjatë këtij rigjykimi pa mëdyshje janë vërtetuar veprimet e të akuzuarve ndaj të dëmtuarve që i përfaqësoj unë, kështu që propozoj që gjykata të njëjtit t’i shpallë fajtorë për të cilët është ngritur kjo aktakuzë dhe që me aktgjykim t’i obligoj që të dëmtuarve t’ua kthejnë shumat e parave, të cilat janë theksuar në dispozitiv të aktakuzës gjithmonë sa i përket të dëmtuarve Zef dhe Pal Gruda”.*

[...]

*Nga shqyrtimi i kaluar, atëherë përfaqësuesi i të dëmtuarve avo. Arianit Koci, fjalën përfundimtarë gjykatës ia ka paraqitur në formën e shkruar e cila i është bashkangjitur shkresave të lëndës dhe aktgjykimit ku në fund ka kërkuar nga gjykata, pasi të vërtetohet shumat e përgjithshme e demit material të shkaktuar ti urdhërojë të pandehurit përkatës që solidarisht tua kompensojnë të dëmtuarve, dëmin e shkaktuar material, në shumën dhe vëllimin e caktuar nga gjykata sipas aktgjykimit të mbështetur në provat e administruara në shqyrtimin kryesor.*

[...]

*I dëmtuari dëshmitari Pal Gruda: ka qëndruar në tërësi pranë deklaratës se tij të dhënë në polici dhe në prokurori, kurse gjatë shqyrtimit kryesor kur është dëgjuar në cilësinë e të dëmtuarit dhe dëshmitarit, ai në fillim ka folur për jetën studentore në Tiranë dhe*

[...]

*I akuzuari K. K. në shqyrtimin kryesor është mbrojtur në heshtje, duke më pranuar veprën penale, mirëpo gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarave Pal dhe Zef Gruda e posaçërisht të dëmtuarit Pal Gruda i cili gjatë shqyrtimi kryesor në mënyrë bindëse ka përshkruar të gjitha detajet e kontakteve me të akuzuari K.K., i cili e ka shtyre në borxhe në shumta të mëdha të dëmtuarin Pal i cili nuk ka qenë në gjendje që ta paguajë jo vetëm borxhin e ofruar por edhe kamatat e larta apo fajde të cilat ia ka parashtruar i akuzuari Kastriot dhe detyron që të paguaj shumta jo proporcionale.*

[...]

*“Trupi gjykues vlerësoj deklaratën e të dëmtuarave Pal dhe Zef Gruda, nga se dëshmitë e tyre ishin bindëse, në të cilat treguan ter rrjedhjen e ngjarjes duke filluar nga kontaktet e para që ka pasur i dëmtuari Pal me të akuzuarin B., pastaj i akuzuari duke shfrytëzuar papërvojën e të dëmtuarit e shtinë në borxhe atë duke i dhënë shumta të larta të huave në të holla duke ia llogaritur kamatat e larta dhe për pamundësinë që ti paguaj B., e ka kërcënuar të dëmtuarin, e ka detyruar duke i thënë se do të vijë në familje, vim me fajdexhit grup, në shtëpi, në dyqan, me ardh me forcë me i marrë parat prej familjareve.”*

68. Në kontekst të pretendimit për shkelej të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së si rezultat i pamundësisë për shfrytëzim të mjeteve juridike përgjatë gjithë procesit gjyqësor para gjykatave të rregullta, respektivisht kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore [PKR. nr. 76/18], Gjykata vëren se Prokuroria Speciale kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër të akuzuarve.
69. Gjithashtu, në kontekst të pretendimit të parashtruesve për pamundësinë e paraqitjes së pretendimeve në Gjykatën e Apelit, Gjykata në këtë pikë do të i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, i cili thekson si në vijim:

*“Gjykata e Apelit duke marrë për bazë faktin se disa nga të dëmtuarit kishin parashtruar kërkesa pasurore juridike të cilat kërkesa në esencë nuk përkonin me lartësinë e parashtruar të kërkesës në raport me dëmin e pretenduar, kjo gjykatë vetëm ka konstatuar që kërkesat mund të realizohen në procedurën civile kontestimore, duke qenë se për Gjykatën e Apelit baza për kompensimin e dëmit ekziston e që rezulton si pasojë e fajësisë së të akuzuarve që kjo gjykatë ka konstatuar [...]*

70. Për më tepër, në kontekst të pretendimit të parashtruesve të kërkesës për pamundësinë e pjesëmarrjes në seancat e zhvilluara në Gjykatën Supreme, Gjykata rikujton se rasti i parashtruesve të kërkesës nuk kishte përfunduar përmes Aktgjykimit të kontestuar [PA-II. nr. 2/2020], të 8 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme, por rasti ishte kthyer në rigjykim në Gjykatën e Apelit për rivendosje dhe kjo e fundit përmes Njoftimit [APS. nr. 43/2020] të 3 nëntorit 2020, kishte ftuar palët relevante në rast, duke përfshirë edhe parashtruesit e kërkesës që të merrnin pjesë në seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit lidhur me rigjykimin e rastit.

71. Përveç kësaj, Gjykata nga dosja e rastit vëren se Gjykata e Apelit në ri procedurë përmes Aktgjykimit [APS.nr.43/2020] në përgjigje të pretendimeve të parashtruesve për mos dorëzim të Aktgjykimit [APS.nr. 6/2019] të Gjykatës se Apelit, të 4 majit 2020 dhe Aktgjykimit [PA-II. nr. 2/2020] të Gjykatës Supreme, të 8 tetorit 2020, si dhe për pamundësinë që të ngrinin pretendime në gjykatat e rregullta, kishte konstatuar qartazi si në vijim:

*“Fillimisht gjykata e apelit për sa i përket pretendimit se të dëmtuarave nuk u janë dorëzuar aktgjykimet e gjykatës se shkallës se parë dhe aktgjykimet e gjykatës se Apelit, kjo gjykate rikujton se dorëzimi i vendimeve tek cilado pale qofshin ato te gjykatës se shkallës se parë apo edhe te shkalleve te tjera gjyqësorë behet nga gjykata e shkallës se parë, përkundër se ne seancën e mbajtur me date 22.01.2020, në gjykatën e Apelit, të dëmtuarit Pal dhe Zef Gruda kanë qenë prezent në seancë dhe për asnjë moment nuk kanë shfaqur një rrethanë të tillë të mos dorëzimit të aktgjykimit të gjykatës se shkallës se parë. Për me tepër, siç rezulton nga shkresat e lendes të dëmtuarit Pal dhe Zef Gruda nga fletkthesat rezultojnë se ata kishin pranuar aktgjykimin e gjykatës se shkallës se parë me datën 24.05.2019 me shenjen 76/2018, dhe se pranimin e kishin bere me date 27 dhe 28.06.2019 ne ora 15:00, qka rezulton se një pretendim i tillë i cenimit të të drejtave për mos dorëzimin e aktgjykimit është i pabazuar, ndërsa fakti se ishin prezent në seancën e gjykatës se Apelit konfirmohet sipas fletkthesave dhe procesverbalit të seancës se datës 22.01.2020. Nga të gjitha këto, gjykata e Apelit vëren se të dëmtuarit kishin mundësin për ushtrimin efektiv të mjeteve juridike, po ashtu edhe tani në rigjykim pas vendimit të gjykatës Supreme të dëmtuarit kanë qenë prezent në seancën e kolegjit në gjykatën e Apelit”*

72. Nga sa me sipër, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës **(i)** kanë pranuar Aktgjykimin [PKR. nr. 76/18] e 24 majit 2019 me 27 dhe 28 qershor 2019; **(ii)** kanë marrë pjesë në seancën e 22 janarit 2020 të Gjykatës se Apelit dhe kishin patur mundësin që të ngrinin pretendime lidhur me rastin e tyre; **(iii)** si dhe kanë marrë pjesë edhe në seancën e zhvilluar në ri-procedurë në Gjykatën e Apelit.
73. Gjykata gjithashtu e konsideron të nevojshme të vë në pah se parashtruesve të kërkesës u është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ata kanë mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të parashtrojnë argumente dhe dëshmi që ata i kanë konsideruar të rëndësishme për rastin e tyre; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë gëzuar garancitë procedurale të ngërthyera në konceptin e gjykimin të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI118/17](#), parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih rastin e GJEDNJ-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
74. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës refuzohet si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

***Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.***



75. Sa i përket çështjes lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka ngritur këtë çështje duke pretenduar në esencë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
76. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thekson: *“Po të më mundësohej paraqitja e ankesës kundër Aktgjykimit të apelit, për çështje të kërkesës pasurore juridike dhe për shpenzimet kolosale të procedurës, po të ftohesha në seancë të Kolegjit në Gjykatën Supreme të Kosovës, sigurisht që do të prezantoja pretendimet e mia. Pse Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit nuk më ka gjykuar dëmin e shkaktuar, i cili është vërtetuar në procedurën penale”.*
77. Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 76/18] të 24 majit 2019 dhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS. nr. 6/2019] të 4 majit 2020 kishin vendosur që parashtruesit e kërkesës ta realizojnë kërkesën pasurore juridike në kontest civil në cilësinë e palës së dëmtuar.
78. Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj, palët e dëmtuara duke përfshirë parashtruesit e kërkesës në cilësinë e të dëmtuarve i ka udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në procedurë civile kontestimore, duke theksuar si në vijim:
- “Të dëmtuarit Pal Gruda, Zef Gruda, F.F., B.Q., M.N., B.N., F.G., Sh.B., M.A., N.Q., K.G., dhe A.Z., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil”.*
79. Gjithashtu, Gjykata i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit [APS. nr. 6/2019] të 4 majit 2020, të Gjykatës së Apelit, ku theksohet:
- “Gjykata e Apelit duke marrë për bazë faktin se disa nga të dëmtuarit kishin parashtruar kërkesa pasurore juridike të cilat kërkesa në esencë nuk përkonin me lartësinë e parashtruar të kërkesës në raport me dëmin e pretenduar, kjo gjykatë vetëm ka konstatuar që kërkesat mund të realizohen në procedurën civile kontestimore, duke qenë se për Gjykatën e Apelit baza për kompensimin e dëmit ekziston e që rezulton si pasojë e fajësisë së të akuzuarve që kjo gjykatë ka konstatuar, njëkohësisht për sa i përket lartësisë së kërkesës së parashtruar ajo nuk ishte e qartë, duke qenë se kërkesa ishte në shpërpunje me konstatimet e gjetura për dëmin e shkaktuar nga kjo gjykatë që të akuzuarit iu kishin bërë të dëmtuarave, e meqë gjykata udhëhiqet nga parimi i efikasitetit në procedurën penale duke mos i cenuar të drejtat e palëve mbi bazën e këtij parimi ndërmarrja a e veprimeve për çfarëdo ekspertize financiare për të konstatuar lartësinë e kërkesës së të dëmtuarave do të tejzgjaste procedurën penale, mbi të gjitha këto arsye gjykata mbështetur në nenin 463, të KPP-së ka vendosur që kërkesa të realizohet në procedurën civile kontestimore nga të dëmtuarit”.*
80. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte anuluar nga Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PA-II. nr. 2/2020] të 8 tetorit 2020, për arsye të zbatimit të ligjit penal dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim në Gjykatën e Apelit.
81. Megjithatë, Gjykata nuk mund të mos vërej se parashtruesit e kërkesës janë udhëzuar në kontest civil për ta realizuar kërkesën pasurore juridike në cilësinë e palës së dëmtuar.
82. Në këtë aspekt dhe në përgjigje të pretendimit të parashtruesve të kërkesës sa i përket çështjes së kërkesës pasurore juridike, Gjykata rikujton se në nenin 463, paragrafi 1 të

Kodit të Procedurës Penale theksohet se "Për kërkesat pasurore-juridike vendos gjykata. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton që: "Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore-juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore-juridike mund ta realizojë në kontest civil".

83. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nga gjykatat e rregullta është udhëzuar në procedurën përkatëse për realizimin e kërkesës pasurore juridike, nga kjo rezulton që parashtruesit e kërkesës kanë mundësi të ndjekin procedurat civile për kërkesën e tyre pasurore-juridike.
84. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substancë" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, po ashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, [KI71/18](#), parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafit 57).
85. Duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar në kërkesë nëse, për të realizuar kërkesën e tij, ai ka ushtruar mjetet juridike që i kishte në dispozicion, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
86. Prandaj, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës hedhet poshtë nga Gjykata në pajtim me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.
87. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se (i) pretendimi për shkelje të të drejtave dhe liriëve të garantuara me nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës deklarohet si qartazi e pabazuar; ndërsa (ii) pretendimi për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, deklarohet si e parakohshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të neneve 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, njëzëri me 4 prill 2023

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Selvete Gërxhalju-Krasniqi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani